



DATE/A:	05.10.2022
PËR/ZA/TO:	Asamblenë Komuna në Deçan Kryesues z. Hajdar Sutaj
NGA/OD/FROM:	DKA – z. Besnik Hula
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për aprovimin e komisionit për përzgjedhjen e Drejtorit/zëvendës drejtorit të shkollave në komunën tonë.

Të nderuar,

Bazuar në Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësit e Drejtorit dhe Zëvendës drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, Neni 6 pika 3.1 Dy anëtarë të komunës të cilët propozohen nga DKA dhe miratohen nga Kuvendi Komunal. Anëtari i parë është i punësuar në DKA, ndërsa anëtari i dytë i propozua nga DKA, duhet të jetë njeri nga këta tre: ekspert i pavarur i arsimit, drejtor i institucionit arsimor me performancë të lartë, përfaqësues nga këshilli i prindërve në nivel komune me kualifikim dhe ekspertizë në fushën e edukimit.

Andaj bazuar në Udhëzimin Administrativ të cekur më lartë për procedurën e rekrutimit të Drejtorëve dhe zv. Drejtorëve të Shkollave në Komunën tonë, propozojmë për votim në asamblenë komunale në Deçan komisionin (për një vit shkollor 2022-2023):

1. **DKA – z. Xhevat Bozhdaraj – Udhëheqës i Sektorit të Arsimit**, nga fshati Carrabreg i Epërm, komuna e Deçanit, i lindur më 24.04.1967, Studimet në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, shkolla e Lartë e Pedagogjisë, Bachelor i Historisë dhe Gjeografisë, (diplomuar në vitin 1990). Pastaj vazhdojë studimet master në Kolegji "Biznesi" në Prishtinë në drejtimin Menaxhment dhe Financa, i përfundoj në vitin 2014. Karrierën e fillojë në vitin 1990 – 2015 mësimdhënës, në Shkollën Filllore Mesme e Ulët "Avni Rustemaj" në Irzniq dhe Shkollën Filllore Mesme e Ulët "Sylejman Vokshi" në Prejlep. Në vitin 1999 – 2000 në Zvicër punësohet Mësimdhënës për mësim plotësues për nxënës shqiptar, viti 2009-2015 Kordinator për Arsim në DKA-Deçan (Zhvillimi profesional i mësimdhënësve). Në vitin 2015 punësohet në Komunën e Deçanit Udhëheqës i Sektorit të Arsimit. z. Bozhdaraj ka gjithsej 25 vite përvojë pune në arsim).
2. **Përfaqësues i pavarur i arsimit – z. Avdyli Shala** nga fshati Dubovik, komuna e Deçanit, i lindur më 31.05.1955, Studimet në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti Filozofik, Drejtimi Gjuhë dhe Letërsisë Shqipe, (diplomuar në vitin 1981). Karrierën e filloi në Shkollën Filllore Mesme e Ulët "Fan Noli" në Kryshec, Pastaj punësohet në Shkollën Filllore Mesme e Ulët "Jusuf Gërvalla" në Prapaqan, fillimisht si mësimdhënës e në vitin 1995 emërohet Drejtor shkolle, detyrë që mbajti për më shumë se dy dekada, deri në vitin 2020 (pensionimi).
3. Një anëtar nga MASH, i cili përcaktohet nga MASH, pasi që ka marrë njoftim zyrtar, emili zyrtar nga DKA-ja.

Dr. Arsimi 37931
01 18.10.22